



PUNONJESI SOCIAL PER MOSHEN E TRETE

KUSH ESHTË PUNONJESI SOCIAL PER MOSHEN E TRETE

Nga statistikat e fundit demografike të INSTAT del se indeksi i moshës së pleqërisë po rritet duke regjistruar një rritje në jetëgjatësinë mesatare dhe një ulje të konsiderueshme të lindshmërisë. Kjo është arsyeja pse del nevoja për të trajnuar punonjës socialë të specializuar, të aftë për të ofruar ndihmë profesionale për të moshuarit. Punonjësi Social për moshën e tretë është një figurë profesionale e shumë kërkuar nga familjet ose ente private që ofrojnë shërbime të kujdesit në familje.

C'FARE BEN PUNONJESI SOCIAL PER MOSHEN E TRETE

Punonjësi social për moshën e tretë asiston me kompetencë dhe profesionalizëm të moshuarit, duke i dhënë konfort dhe mbështetje të çmuar këtyre njerëzve në nevojë në fazën delikate të pleqërisë. Punonjësi social ndihmon të moshuarin në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, ofron ndihmë spitalore gjatë ditës dhe natës, administron ilaçet duke ndjekur udhëzimet mjekësore, siguron higjienën personale të të moshuarve dhe përgatitjen e vakteve.

Përmes mbështetjes së vyer që i ofron personit të asistuar, ky punonjës ndihmon në këtë mënyrë fëmijët e të moshuarit, rikthen ekuilibrin familjar, forcon lidhjet emocionale, menaxhon konfliktet dhe krijon marrëdhënie bashkëpunimi me familjen e personit të asistuar.

SI TE BEHEM PUNONJES SOCIAL PER MOSHEN E TRETE

Shumë njerëz në nevojë janë njerëz të moshuar, pothuajse autonomë, të cilët thjesht duan të vazhdojnë të jetojnë në shtëpinë e tyre në mënyrë të pavarur, në qetësi

Në Kursin për punonjës socialë për të moshuarit mund të marrin pjesë ata të cilët duan të jenë pjesë e botës së asistencës private, dhe duan të bëhen profesionistë të vërtetë në sektorin e përkujdesit.

Kriteret minimale të kërkuara për tu regjistruar në kursin e punonjësve socialë për të moshuarit janë të qenit në moshë madhore, një trup i shëndetshëm dhe i fortë, Predispozitë e shkëlqyer ndaj marrëdhënieve njerëzore dhe ndërpersonale, Predispozitë e shkëlqyer për të punuar në kontakt me njerëz